EKSPOZITË

Cikli i Jetës

Muzeu Etnografik “Emin Gjiku”

Prishtinë, Maj 2014

Support to the Promotion of Cultural Diversity

Funded
by the European Union
and the Council of Europe

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Muzeu Etnografik “Emin Gjiku”

EKSPOZITË

Cikli i Jetës

Prishtinë, Maj 2014

// Mirënjohje

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për ekipin, të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e rastit studimor në faza të ndryshme:

Julija Trichkovska
Specialiste e PDKK-së mbi trashëgiminë kulturore

Avni Manaj
Koordinator i PDKK-së për kapacitetet institucionale për trashëgiminë

Prof. Dr. Ukë Xhemaj
Ekspert vendor

Ilir Sopjani,
*Etnolog, Muzeu i Kosovës**

Erodita Qorkadiu
Etnolog, Muzeu I Kosovës

Anduena Balaj
Etnolog, Muzeu i Kosovës

Fatos Bimbashi
Etnolog, Muzeu i Kosovës

Atdhe Mulla
Fotograf

Ky dokument është prodhuar brenda kornizës së projektit të përbashkët "BE/KE - Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë".
Përmbajtja nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe/apo të Këshillit të Evropës.

Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

// Prekur nga trashëgimia e luajtshme

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, së bashku me Këshillin e Evropës, është krenare që është në gjendje të ndihmojë për të vendosur standarde të qëndrueshme në vlerësimin, rivendosjen dhe ruajtjen e trashëgimisë në Kosovë, si të luajtshme ashtu dhe të paluajtshme. Bashkëpunimi ynë me Muzeun Etnografik Emin Gjiku sigurisht ka qenë një nga përvojat më të gjalla të projektit që siguron "Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë".

Kur flasim për trashëgiminë e luajtshme, nuk është qe vetëm objektet e së kaluarës që janë duke lëvizur nëpër kohë; jemi poashtu edhe ne që bashkëveprojmë me këto objekte dhe prekemi nga madhështia apo thjeshtësia e paraardhësve tanë, e përmes kësaj ne mund të kuptojmë më mirë pikat e forta dhe dobësitë e vetë kohës sonë.

Artisti kosovar bashkëkohor vizual, Alban Muja, e titulloi "Muzeu i Historisë Bashkëkohore" veprën e tij artistike që përshkruan urën mbi lumin Ibër mes Mitrovicës së jugut dhe të veriut. Kjo oksimaron, një kombinim i dy fjalëve zakonisht të papajtueshme, më erdhi në mendjen kur m'u prezantua publikimi i Muzeut Etnografik, "Cikli i Jetës". A nuk është cilido mjedis në një muze etnografik në fakt gjithmonë, dhe me përkufizim, "një histori bashkëkohore", apo, thënë më saktë, "historia e bashkëkohores". Muzeu etnografik ndërton historinë e vet pikërisht përmes shumë episodeve të njëpasnjëshme të të tashmeve të ndryshme bashkëkohëse. Duke rrëfyer historinë e momenteve ndërtohet historia.

Momente të tilla mund të jenë një objekt i thjeshtë, një gjurmë materiale e një zakoni të caktuar, brendësia e një ndërtese ose i tërë peisazhi i krijuar nga njeriu - secili prej këtyre shkruan një pjesë të historisë. Duke ecur përmes dhomave të Muzeut Etnografik në Prishtinë, historia e Kosovës bëhet e prekshme dhe e dukshme - bëhet bashkëkohore.

Së fundi, kur muzeu vendosi të shfaqë disa nga eksponatet më të bukura nga koleksioni i tij në katalogun që tash keni para jush, kjo histori mori një tjetër kthesë dhe u bë një objekt më vete. Mund të imagjinohet një vizitor i frymëzuar duke lëvizur nga një objekt në tjetrin me katalogun në duart e tij - por ky libër mund t'i sigurojë, edhe një admiruesi të largët që mbase kurrë nuk ka shkelur në Kosovë, një udhëtim imagjinar përmes ekspozitës, duke i thënë: "Lëviz dhe njih!"

Samuel Žbogar
Shef i Zyrës së BE-së në Kosovë
dhe Përfaqësues i Posaçëm i BE-së

// Parathënie

Muzetë kanë një rol të veçantë në shoqëri; mbështetjen e ndryshimeve pozitive shoqërore, duke siguruar një copë jete nga e kaluara, e tashmja, madje edhe parashikime për të ardhmen. Ata konkretisht paraqesin çka vlerëson një komunitet specifik në lidhje me trashëgiminë e tyre dhe atë që ata do të donin të trashëgonin gjeneratat e ardhshme. Vlera e tyre edukative është e pamohueshme, duke kontribuar në jetën bashkëkohore të komuniteteve, në jetë shoqërore dhe ekonomike.

Ekspozitat janë një formë e ndërmjetësimit të imazhit mes perceptimeve të vendeve specifike, popujve, historive dhe peisazheve. Ato janë një akt fuqizimi për komunitetet për imazhin që ata kanë për veten dhe mënyrën si ata do të donin ta paraqisnin veten në botë. Ato tregojnë shumë rreth sistemeve të vlerave të shoqërisë dhe interpretimit të tyre në një periudhë të caktuar të historisë.

Publikimi i "Ciklit të Jetës", me këtë temë universale, ofron një ekspozitë të veçantë të një koleksioni të materialeve, ku është e lehtë të udhëtosh në kohë, të njohësh rituale të ndryshme dhe të reflektosh mbi kulturat e tyre përkatëse. Eksponatet e koleksionit të dokumentuara në këtë publikim ofrojnë një mundësi për ata që nuk e kanë vizituar ende dhe janë joshur nga arkitektura plot finesë e kompleksit "Emin Gjiku" dhe atmosfera e tij e veçantë.

Duke përjetuar ndryshimin e pamjes së qendrës historike të Prishtinës, kompleksi "Emin Gjiku" ruan identitetin e vet në lagjen e vetmuar të qytetit, dhe i drejtohet botës përmes këtij botimi, duke na rikujtuar ritualet thelbësore të ciklit të jetës, pa marrë parasysh se nga vijnë. Era e leshit në një vegjë, forma e një kupe, përzierja e ngjyrave në një qëndisje, zhurma e një instrumenti, gdhendja në një sënduk druri, drita që bie përmes dritareve: të gjitha këto nxisin kujtime të motiveve të tjera të prekura dhe të ndiera gjetkë, dhe të tregimeve të vjetra të treguara nga të tjerët. Vizitorët në muze kuptojnë se ka një ngjashmëri mes asaj që është paraqitur dhe asaj që ata kujtojnë dhe nuk harrojnë: njerëzit jetojnë, dashurojnë dhe vdesin, dhe ky "Cikël i jetës" është çka që na lidh së bashku me të gjitha gjërat që jetojnë në këtë planet.

Projekti i përbashkët i BE-së/KiE-së "Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë" punon në drejtim të transformimit progresiv të shoqërive përmes demokracisë pjesëmarrëse, duke shfrytëzuar trashëgiminë si një vlerë të përbashkët. Në përpjekjet tona për të ndihmuar autoritetet vendore dhe shoqërinë civile, ky katalog është një shembull konkret se si Konventat e Këshillit të Evropës, veçanërisht Konventa Faro mbi "Vlerësimin e trashëgimisë kulturore për shoqërinë", janë përkthyer në mjete praktike që janë të rëndësishme për shoqërinë. Katalogu i këtij koleksioni, si një produkt i një procesi të inventarizimit të trashëgimisë së luajtshme kulturore, ishte rezultat i një procesi të gjatë dhe organik të kryer nga projekti PDKK së bashku me institucionet vendore; udhëzuesit e zhvilluar duke u bazuar në standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e trashëgimisë kulturore të Kosovës; zhvillimit të kapaciteteve të institucioneve lokale për trashëgiminë e luajtshme kulturore; hartimit të ligjit për muzetë dhe kryerjes së një procesi të inventarit.

Ne jemi shumë krenarë që paraqesim këtë botim, "Cikli i Jetës", që demonstron nevojën për një muze etnografik të përkushtuar për ruajtjen, paraqitjen dhe shpjegimin e artefakteve, si dhe pritjet e vizitorëve në një udhëtim përmes kohës dhe kulturave.
Teksa botimet janë kontribute të mëdha, ne shpresojmë se ju do t'i vizitoni dhomat e kompleksit "Emin Gjiku" me katalogun dhe do të ndieni atmosferën e jetesës së gjeneratave të kaluara.

Claudia Luciani

Drejtoreshë e Drejtorisë për Qeverisje Demokratike
Drejtorati i Përgjithshëm II - Demokracia
Këshilli i Evropës

// Hyrje

Ky botim është produkt i aktivitetit të kryer nga projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës – Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK).

Si parim në praktikën e projektit PDKK, kjo nismë është realizuar së bashku me palët e interesuara lokale, përfshirë kuratorët e Muzeut Etnografik Emin Gjiku me ndihmën e një eksperti vendor që përzgjodhën ato artikuj muzealë që janë kataloguar në publikim.

Në përgatitje për këtë, u organizuan një numër i sesioneve trajnuese, janë kryer vizita studimore dhe udhëzimet e prodhuara nga projekti PDKK u vunë në praktikë. Me mbështetjen e një eksperti, i cili prezantoi standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, besohet se është ndërmarrë dhe ekspozuar një proces i vërtetë inventarizimi i trashëgimisë së pasur kulturore të luajtshme në Kosovë.

Koncepti i një ekspozite të përhershme në objektin kryesor të kompleksit të muzeut Emin Gjiku kërkoi një qasje të veçantë. Në hartimin e katalogut, koncepti kryesor ishte që të drejtohen vizitorët përmes interierit me dekorim të pasur të ndërtesës, brenda së cilës objektet e ekspozuara shpjegonin dhe evokonin aktivitetet e përditshme dhe rastet e veçanta të përjetuara nga një familje tradicionale. Ne shpresojmë që rezultatet e veprimit tonë të përbashkët do të formojnë një bazë të mirë për punë të mëtejshme për të përfunduar procesin e kategorizimit të më shumë se një mijë artikujve në koleksione.

Për më tepër, ne shpresojmë se kjo vepër jep një kontribut frymëzues për studimin sistematik dhe prezantimin adekuat të artikujve që kërkojnë vëmendje të menjëhershme. Ne inkurajojë ruajtjen e eksponateve të pasura të muzeut, duke marrë masat e nevojshme të ruajtjes në përputhje me përpjekjet e tjera për të ruajtur dhe paraqitur të gjitha asetet dhe praktikat e trashëgimisë në Kosovë përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të integruar.

Projekti PDKK

// Përmbajtja

Marrëdhënia konceptuale 14

Tregimi i ekspozitës 16

Udhëtimi njohës përmes ekspozitës 18

Katalogu 33

1. Orendi

2. Vegla punëdore

3. Vegla bujqësore dhe blegtorale

4. Tekstile folklorike

5. Sende shtëpiake

6. Instrumente muzikore

7. Argjendari

8. Objekte kulti

9. Armë

Një vështrim brenda shtëpisë familjare 119

// Marrëdhënia konceptuale

Kompleksi tradicional i ndërtesës që përbën Muzeun Etnografik Emin Gjiku, i vendosur në "zemër" të Prishtinës së vjetër në zonën e ish-tregut oriental (*çarshisë*), ka qenë një pjesë përfaqësuese e koleksionit etnologjik të Muzeut të Kosovës prej vitit 2006.

Koncepti i ekspozitës së titulluar "Rrethi i Jetës" nga kuratorët e saj, ndjek dizajnin e brendshëm të ndërtesës kryesore të kompleksit, një shtëpi dy-katëshe në pronësi të Emin Gjikut, një tregtar nga Prishtina e shekullit XIX.

Komplekse të tilla rezidenciale të llojit oriental - me oborr të madh, të mbyllur dhe struktura shtesë gjendej kryesisht në zonat urbane që ishin zhvilluar gjatë shekujve të fundit të sundimit osman në Ballkan. Vetë ndërtesa kryesore u bë një shembull përfaqësues i jetës së suksesshme ekonomike dhe të pasur sociale të pronarit të saj. Ajo është e përbërë nga një konstruksion druri *(bondruk)*, me shumë dritare simetrike të mëdha me hapje në oborr, si dhe një strukturë e mbuluar karakteristike *(çardak)* që ofron një pamje të hapur të zonës përreth dhe e cila është përdorur për relaksim dhe tubime sociale. Disa dhoma, të rregulluar në dy katet e ndërtesës, të çojnë në sallat e mëdha qendrore.

Mund të interpretohet se shprehja karakteristike arkitektonike e ndërtesës kryesore dhe dizajni i interierit të saj frymëzuan kuratorët të artikulojnë marrëdhënien konceptuale mes hapësirës dhe artikujve të shfaqur. Në këtë kuptim, imazhi i një tradite të trashëgimisë së gjallë është realizuar plotësisht.

Përballë ndërtesës kryesore, shtëpia tjetër familjare përbëhet nga një kat përdhesë dhe kati i parë i ngritur mbi një platformë të katit përdhesë. Ajo gjithashtu është e rregulluar për të përfaqësuar jetën e përditshme të familjes: hapësira e katit përdhesë shërben si kuzhinë dhe zonë ngrënie, me zonat për grumbullimin e familjes në katin e parë.
Sipas konceptit kryesor të ekspozitës në katalog, kjo shtëpi e familjes është konsideruar si një thesar i traditës popullore, e paraqitur përmes dizajnit të interierit dhe objekteve të artizanatit.

// Tregimi i ekspozitës

Ideja lëvizëse pas dizajnit të ekspozitës së muzeut ishte prezantimi i objekteve nga koleksioni i pasur etnografik i Muzeut të Kosovës, të mbledhur nga i gjithë territori që pasqyrojnë jetën socio-ekonomike të popullsisë në shekujt XIX dhe XX.

Termi "Cikli i Jetës" lidh artikujt e koleksionit të paraqitura brenda mjedisit specifik dhe kuptimplotë me të cilin janë të lidhur. Zakonet dhe praktikat e lidhura me momentet kyçe të jetës së njeriut shpjegohen përmes objekteve të ekspozuara në dhoma të ndryshme të shtëpisë, të tilla si "Dhoma e Lindjes", në katin përdhesë dhe "Dhoma e ritit të vdekjës" në katin e parë.

Duke shkuar nëpër të katër dhomat e tjera të shtëpisë përmes korridoreve të gjera, mund të hasësh mënyrën e jetesës tradicionale të një familjeje shqiptare përmes mbi një mijë sendeve që i kanë shërbyer qëllimeve të ndryshme.

Këto përfshijnë vegla shtëpiake të përdorura në përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit; vegla për kultivimin e tokës, si dhe pajisje bujqësore e blegtorale; dhe vegla për tekstile dhe për veshje karakteristike tradicionale, siç janë prodhuar nga punëtoritë artizanale lokale ose nga gratë në shtëpi nga rajonet e ndryshme të Kosovës. Ka edhe eksponate me stoli për raste të veçanta, si dhe instrumente tradicionale muzikore (kryesisht frymore) të cilat janë elementet e kulturë së pasur muzikore lokale. Aty mund të gjeni artikuj interesantë të bestytnisë (objekte të kultit - hajmali), kundër syrit të keq, përdorur që nga kohërat e lashta pagane. Disa pushkë, të prodhuara në vend, janë të ekspozuara si një kujtesë se jeta dhe rrethanat ishin të pasigurta, kështu që armët ishin të zakonshme në mesin e familjeve.

Praktikat kulturore të paraqitura këtu kanë marrë formë në nivel lokal, në kushte materiale dhe shpirtërore. Në një nivel më të përgjithshëm, shumica e traditave janë të lidhura ngushtë me kulturën e gjallë orientale që ka qenë e pranishme në rajon për shekuj

// Udhëtimi njohës
përmes ekspozitës

P

Kati përdhesë



1. *Pjesa e hyrjes*
2. *Korridori*
3. *Dhoma e artit folklorik*
4. *Dhoma e lindjes*
5. *Oda e burrave*

01/ Pjesa e hyrjes

Tipari më karakteristik i pjesës së hyrjes është çardaku. Vendi i uljes *(minderi)* është rregulluar rreth një galerie me xham, dhe është e mbuluar me jastëkë të qëndisur dhe qilima me materiale të endura. Një qilim i endur i kuq, i qëndisur me katër motive të përsëritura gjeometrike me ngjyra të ndryshme, mbulon dyshemenë. Qilim tjetër i kuq, me origjinë nga rajoni i Drenicës dhe me formë dhe madhësi që përputhet me rregullimin hapësinor të korridorit, është i zbukuruar me një pemë të stilizuar të përdorur si motiv i përsëritur përgjatë pjesës qendrore (Kat. Nr. 31).

02/ Korridori

Qendra e këtij seksioni përmban një eksponat të një veshjeje gruaje *(xhubleta)*, me origjinë nga Malësia *(Kat. Nr.44)*, me fundin e valëzuar ne formë kambane tepër interesant. Sipas studiuesve, forma unike e fundit është e lidhur me peizazhin dhe relievin e Alpeve Shqiptare, nga e ka origjinën. Ngjyrë e zezë që dominon këtë lloj të veshjes tregon se ishte veshje vetëm për gratë e martuara dhe/ose të moshuara. Pasurimi i materialit është arritur duke gërshetuar leshin në katër shirita paralelë *(liq)*.

Dy sëndukë druri për ruajtjen e veshjeve janë gjithashtu në korridor, një i dekoruar me gdhendje me lule, dhe tjetri me aplikimin e metaleve me ngjyrë mbi lëkurë dhie (Kat. Nr. 3 dhe 4).
Këto janë ndër objektet më arketipe të koleksionit të mobiljeve të Muzeut.

Më pas, vizitori drejtohet drejt dy pushkëve *(karamfile)* (Kat. Nr. 134,135), prodhuar në Prizren në vitin 1878 gjatë periudhës që lidhet me aktivitetet e Lidhjes së Prizrenit. Për shkak të cilësisë së materialit të përdorur dhe modulimit artistik të ornamenteve duke përdorur teknikën e filigranit, këto objekte janë konsideruar si kryevepra të artizanëve lokalë të Prizrenit, zeja e të cilëve ishte popullore në tregjet evropiane dhe më gjerë.

Objekte të tjera të ekspozuara përfshijnë shembuj të mobiljeve prej druri: një tryezë e ulët, e rrumbullakët ngrënie *(sofra)* me karrige me tri këmbë të përdorura nga fëmijët (Kat. Nr 14) është e vendosur në afërsi të "Dhomës së Lindjes" (çerdhes); artikuj për ruajtjen dhe shërbimin e produkteve të qumështit dhe ujit (Kat. Nr. 72-74, 83) dhe një stol për fëmijë (Kat. Nr. 17). Një zgjedhë druri shfaqet këtu (Kat. Nr. 27) karakterizohet nga motivi qendror i një gjarpri në basoreliev, që simbolizon besimin se gjarpërinjtë mbrojnë bagëtinë gjatë punës në arë.

Një tjetër lloj tryeze të ulët, të rrumbullakët, e përdorur për të shërbyer ushqim *(sinia)* është bërë nga metali dhe gdhendur me ornamente floreale në rrathë koncentrikë (Kat. Nr. 86). Është shfaqur në këtë pjesë si një shembull përfaqësues i sendeve shtëpiake metalike.

03/ Dhoma e artit folklorik

Një numër i konsiderueshëm i artikujve shtëpiakë prej druri dhe metali janë shfaqur në "Dhomën e artit folklorik", shumë prej të cilave janë të gdhendura. Dhoma përmban edhe vegla pune për dru, lëkurë dhe punë metalike. Më karakteristike ndër këto, në aspektin e formës, teknikës apo dekorimit, është një enë për pjekje buke *(qerepi)* prej balte të pjekur zbukuruar me motive të diellit (Kat. Nr. 94); një kallëp prej druri për të bërë këpucë tradicionale *(opinga)* zbukuruar me vija dhe pika në basoreliev (Kat. Nr. 22); një hekur i vogël, i sheshtë, prej metali solid, me një dorezë të lakuar dhe zbukuruar me ornamente të gdhendura gjeometrike (Kat. Nr. 87); një enë prej balte të pjekur, me ngjyra dhe me xham, dhe veshur me ornamente floreale që hapen në formën e një gjarpri (Kat. Nr. 98); dhe një ibrik metalik popullor, me stil oriental për ujë (ibrik) (Kat. Nr. 88).

Filxhani i kafes prej argjendi (Kat. Nr. 90) dallohet si një produkt i jashtëzakonshëm i artizanatit lokal. Një karakteristikë e zakonshme në interieret e shtëpive të familjeve të pasura ishte dekorimi me gdhendje druri – një art popullor i zhvilluar gjerësisht në shekullin XIX në të gjithë Ballkanin. Disa pjesë druri të gdhendur apo dekoruar në basoreliev janë paraqitur në këtë dhomë: pjesë e një tavani prej druri në formën e një rozete, një kanat sepeti me dekorimin të gdhendur ornamentesh floreale (Kat. Nr. 2), dhe një stol me ornamente gjeometrike dhe me lule në panelin e uljes, si edhe në buzët e mbështetëses me gdhendje në basoreliev (Kat. Nr. 16). Teknika e basorelievit është përdorur gjithashtu për të dekoruar sipërfaqen e një lese prej druri (Kat. Nr. 80), si dhe një tabaku kafeje (Kat. Nr. 77).

Një artikull unik i importuar është llamba metalike me vajguri (Kat. Nr. 89). Dallimi i saj është i qartë nga mbishkrimi rreth mekanizmit ndezës ("KORNGER&G*BERLIN"), si dhe në ikonografinë e ornamentit të gdhendur në sipërfaqen e llambës. Katër skenat që janë të përfaqësuara në pjesën qendrore të objektit tregojnë historinë e mbërritjes në një vend të sapozbuluar me peisazhe ekzotike; ato portretizojnë kapitenin e një anijeje që mban një teleskop, me një marinar në një varkë që afrohet në breg; dy anëtarë fisi në një varkë; një anëtar fisi mbi kalë kalon nëpër një peisazh me palma; dhe një ndeshje mes një elefanti dhe një tigri, me një anëtar fisi të armatosur të ulur në shpinën e elefantit. Në sipërfaqen e bazës, katër skena të tjera të gdhendura i shtohen temës së ornamenteve: dy anëtarë fisi që mbajnë një barelë druri; një anëtar fisi dhe një llama; një burrë dhe një grua në një varkë afrohen në breg, dhe një imazh i një luani.

04/ Dhoma e lindjes

Objekti kryesor në këtë dhomë, e lidhur me lindjen e një anëtari të ri të familjes, është djepi prej druri (Kat. Nr. 18). Forma e lakuar e këmbëve dhe doreza gjysmërrethore lehtësojnë përkundjen e djepit, që i vë fëmijët në gjumë. Zbukurim i thjeshtë gjeometrik në basoreliev dekoron sipërfaqen e jashtme.

Derisa nëna e re kalon shumicën e kohës së saj me fëmijën e porsalindur, një sënduk me teshat që ajo ka sjellë në shtëpi kur është martuar (Kat. Nr. 9) dhe një kuti druri për stoli (Kat. Nr. 10) i janë shtuar kësaj dhome.
Rrethuar nga këto objekte personale, në një dhomë me të porsalindurin e saj dhe e ndarë nga pjesa tjetër e familjes, nënës së re i lejohet një nivel i intimitetit që pjesa tjetër e familjes së madhe nuk e kanë.

05/ Oda e burrave

Në traditën popullore shqiptare, dhoma e quajtur "Oda" është hapësira më e rëndësishme e shtëpisë së familjes. Ajo është e lidhur me të ashtuquajturin "Kulti i bukës", duke iu referuar traditës së mikpritjes së jashtëzakonshme të treguar nga familjet shqiptare që ndajnë "bukën" me të ftuarit, qofshin vizitorë të planifikuar ose të rastit, të cilët më pas do të jenë të vendosur në këtë dhomë. Oda është e lidhur edhe me mënyrën patriarkale të jetës në të cilat burrat kishin një dhomë të veçantë për tubime shoqërore.

Organizimi tipik dhe dekorimi i hapësirës që përdoret si dhomë për meshkuj është veçanërisht karakteristik në komplekset e shtëpive rurale *(kullat)*. Dhoma është e vendosur në katin e sipërm/të lartë, me një oxhak në qendër rreth të cilit rregullohet një zonë për ulje. Kjo ishte mbi një dysheme druri të gdhendur me një batanije të dekoruar *(qerga)*, nën një tavan të gdhendur prej druri. I gjithë kati ishte i mbuluar me qilima dekorativë. Në mungesë të një zonë të tillë në shtëpinë e Emin Gjikut, një nga dhomat në katin përdhesë u rregullua si Odë tradicionale në mënyrë që të ketë përfaqësim të sajë. Objektet e përdorura zakonisht nga anëtarët meshkuj të familjes apo nga të ftuarit që merrnin pjesë në tubimet e meshkujve janë të ekspozuara këtu: një legen prej druri (Kat. Nr. 79), një instrument me hark (lahutë) bërë me dru dhe lëkurë deleje (Kat. Nr. 99), një hejbe (Duqi) e qëndisur tekstili e përdorur për të mbajtur ushqimin e kafshëve që mbahej në shalë të kalit (Kat. Nr. 71), dhe një shtangë zjarri nga metali (Kat. Nr. 93).

01
Kati i parë

6. *Pjesa e hyrjes*
7. *Korridori*
8. *Dhoma e veshjeve tradicionale*
9. *Dhoma e argjendarisë*
10. *Dhoma e ritit të vdekjës*

06/ Seksioni i hyrjes

Sipër shkallëve, në krye të katit të parë, paraqiten kostume tipike të nuses dhe dhëndrit nga rajoni i Rugovës. Ato janë prodhuar në gjysmën e dytë të shekullit XX sipas traditës; ndërsa kostumi i burrit ka pasur pak ndryshim (Kat. Nr. 64), veshja e grave ka parë disa ndryshime, duke fituar shprehje më të pasur në detaje (Kat. Nr. 38). Një pjesë karakteristike e kostumit të mashkujve është shalli i bardhë që lidhej rreth plisit në verë, ose rreth qafës në dimër. Herë pas here, është përdorur edhe për të mbuluar fytyrën e një të vdekuri *(si qefin)*. Pranë kostumeve është një sënduk modest prej druri për ruajtjen e veshjeve, zbukuruar me ornamente gjeometrike (Kat. Nr. 6).

07/ Korridori

Artikuj nga dy koleksioneve të veçanta muzeale janë paraqitur në këtë seksion: objekte kulti (amulete) dhe instrumente tradicionale muzikore.

Materiali më i zakonshëm për bërë amulete ishin dhëmbët e kafshëve (ujq, arinj, qengja) futur në kuti argjendi të gdhendur (Kat. Nr. 130-133). Këto artikuj vendoseshin zakonisht në djepin ose krevatin e fëmijës, ose janë përdorur nga nuset si varëse, sepse besohej se mund t'i mbronin anëtarët më të rinjë dhe më të rrezikuar të familjes nga forcat e këqija dhe sëmundjet e rrezikshme.

Instrumentet tradicionale muzikore më të njohura (Kat. No. 100-111) janë shfaqur pranë këtij koleksioni të amuleteve. Shumica janë instrumente druri frymore, zbukuruar me dizajne të thjeshta gjeometrike në basoreliev, dhe janë të njohura me emrat *lokalë si zurla, kavalli, lahuta, sharkia, tatirangja, dhe fyelli*. Një kopje e një instrumenti unik, tradicional me baltë të pjekur dhe ngjyrosur është okarina (Kat. Nr. 107). Është interesante të theksohet se krijuesit e instrumenteve muzikore popullore, veçanërisht të instrumenteve frymore, dhe vetë muzikantët më të mirë ishin zakonisht barinjë që kalonin muaj të gjatë në male.

Edhe dy tavolina të gdhendura prej druri për shërbim kafeje dhe çaji janë paraqitur në këtë seksion (Kat. Nr.15 dhe 15A). Gdhendjet floreale që ndjekin formën gjashtëkëndore të tavolinave dekorojnë panelet sipërme dhe të poshtme. Këto eksponate shpërfaqin traditën popullore të gdhendjes së drurit.

08/ Dhoma e veshjeve tradicionale

Në këtë dhomë paraqiten artikujt që lidhen me prodhimin e pasur të tekstileve artizanale. Modelet e kostumit tradicional të femrës zbulojnë karakteristikat e ndryshme të rajoneve të ndryshme, të tilla si Hasi, Opoja, Gora, Dukagjini, Medvegja, dhe Rrafshi i Kosovës (Kat. Nr. 39-43, 46-48). Kjo veshje përbëhej nga disa shtresa të veshjeve - ndonjëherë duke arritur deri në dymbëdhjetë pjesë (Kat Nr.43). Vëmendje e veçantë është tërhequr mbi dekorimin e pasur të jelekut të shkurtër, një tipar karakteristik i veshjeve të nuseve të tipit oriental (Kat. Nr. 49 - 57). Këto veshje tekstile përfaqësojnë punën e duruar krijuese të grave lokale që kanë përpunuar pëlhurë leshi ose pambuku (dhe, më rrallë, mëndafshi) në vegje, kanë qëndisur veshjet me gërsheta shumëngjyrësh ose rruaza. Veglat kryesore të përdorura në këtë punë janë shfaqur në këtë dhomë: vegla tekstili (Kat. Nr. 19), vegla tjerrje të leshit (Kat. Nr. 20,21) dhe endëse (Kat. Nr.24-26).

09/ Dhoma e argjendarisë

Krahas stolive në vitrinat brenda mobiljeve origjinale, janë paraqitur më shumë kostume tradicionale. Dy janë kostume nuseje nga rajoni Anadrinisë, një zonë në juglindje të Drinit të Bardhë, dhe dallues të komunitetit boshnjak (Kat. Nr. 36 dhe Kat. Nr. 34). Një kostum i tretë është veshje nuseje tipike orientale, e përdorur zakonisht nga femrat në zonat urbane (Kat. Nr. 34). Kostumi i burrit i paraqitur shërben edhe si veshje e dasmës. Nga rajoni i Drenicës, është i përbërë nga disa shtresa pëlhure me dekorim të pasur që simbolizon statusin social të personit (Kat. Nr. 65).

Shumica e stolive të paraqitura në katalog janë një pjesë integrale e kostumit tradicional të femrës, zakonisht i veshur për raste të veçanta të tilla si dasma. Ato janë prej argjendi duke përdorur teknikën e filigranit, dhe me rruaza apo monedha të aplikuara (Kat. Nr. 112 – 127). Dy kuti argjendi, (Kat. Nr.129) njëra e përdorur për duhanin dhe tjetra për ruajtjen e stolive (Kat. Nr. 128), janë shembujë të aksesorëve në traditën e prodhimeve artizanale të argjendit, zhvilluar në punëtoritë rajonale të Prizrenit, Pejës, Gjakovës, Elbasanit dhe Shkodrës.

10/ Dhoma e ritualit mortor

Cikli i jetës i imagjinuar brenda një familjeje dhe shtëpie tradicionale përfundon në një dhomë që simbolizon edhe lamtumirën e fundit të një anëtari të familjes që ndërron jetë. Veshjet tradicionale të të ndjerit – këtu, një anëtar i vjetër mashkull i familjes – janë rregulluar në qendër të katit. Pranë tyre janë sende që i ndjeri i ka përdorur gjatë gjithë jetës së tij – shkopi i tijë (Kat. Nr. 30) dhe një instrument me hark (lahutë). Ishte e zakonshme që të gjitha këto objekte të vendoseshin në varr së bashku me një mollë të gjelbër, e cila është e lidhur me besimin në vazhdimësinë e jetës pas vdekjës. Gjatë ritualit të vdekjes, të afërmit dhe miqtë e të ndjerit uleshin në shkama (stola) të vendosur rreth trupit (Kat. Nr. 12, 13). Një sënduk, i përdorur nga i ndjeri për ruajtjen e veshjeve të tij, është shfaqur aty pranë (Kat. Nr.7).

// KATALOGU

// KATALOGU
KOLEKSIONI

ORENDI

/1

KANAT SEPETI TË BRENDSHËM, fillimi i shek. të XX ; L: 170 cm, Gjer: 80 cm; dru; dekoruar me pemë, korniza me skaj të dyfishtë e zbukuruar me basoreliev. Nr.Inv. 5651. Paraqitur ne seksionin e hyrjes (çardak) të katit përdhesë. I pa publikuar.

/2

KANAT SEPETI, fundi i shek. XIX; L: 87 cm, Gjer: 42 cm; dru; pjesa qendrore është e dekoruar në dy radhë të gdhendura që paraqesin një pemë me degë dhe lule. Paraqitur në "Dhomën e artit folklorik", kati përdhesë. I pa publikuar.

/3

ARKË, fillimi i shek. XX; L: 108 cm, Gjer: 40 cm, Th: 40 cm; dru; dekoruar me motiv lulesh në basoreliev. Nr.Inv.78. Paraqitur ne seksionin e hyrjes (çardak) të katit përdhesë. I pa publikuar.

/4

ARKË, mesi i shek. XX; L: 96 cm, Gjer: 49 cm, Th: 57 cm; dru; ornament floreal metalik në të gjelbër dhe të kuqe mbi lëkure dhie. Nr.Inv. 257. Paraqitur në korridorin e katit përdhesë. I publikuar: Katalog nga Thesari
Etnologjik i Muzeut të Kosovës, Prishtinë 2013, 27/ Nr. 21

/5

ARKË, fundi i shek. XIX; L: 93 cm, Gjer: 41 cm, Th: 39 cm; dru; ornamente floreale të gdhendura me shirita dhe korniza të harkuara. Nr. Inv. 71. Paraqitur në Odën e Burrave, kati përdhesë. I pa publikuar.

/6

ARKË, fillimi i shek. XX; L: 93 cm, Gjer: 44 cm, Th: 55 cm; dru; ngjyrosur, ornamente të shtypura motivesh gjeometrike në radhë. Paraqitur në "Dhomën e ritit mortor", kati i parë. I pa publikuar.

/7

ARKË, fillimi i shek. XX; L: 90 cm, Gjer: 46 cm, Th: 66cm; dru; ornamente të shtypura motivesh gjeometrike në radhë. Nr. Inv. 71(312). Paraqitur ne seksionin e hyrjes të katit përdhesë. I pa publikuar.

/8

ARKË, fillimi i shek. XX; L: 77 cm, Gjer: 47 cm, Th: 34 cm; dru; dekorim në basoreliev me motive të përsëritura gjeometrike (ornamente me linja horizontale dhe vertikale, rrathë/motivi i diellit, trekëndësha) dhe motive zoomorfike (gjarpri) në dy radhë. Paraqitur në "Dhomën e veshjeve tradicionale", kati i parë. I pa publikuar.

/9

ARKË, fillimi i shek. XX; L: 61 cm, Gjat.: 97 cm, Gjer: 45 cm; dru; basorelieve me ornamente floreale dhe gjeometrike; kunja metalike. Paraqitur në "Dhomën e lindjes". I pa publikuar.

/10

ARKË GJËRASH TË VLEFSHME, mesi i shek. XIX; L: 52 cm, Gjer: 32 cm, Th: 21 cm; dru; ornamente gjeometrike me perla. Paraqitur në "Dhomën e lindjes", kati përdhesë. I pa publikuar.

/11

ARKË ARGJENDARIE, fillimi i shek. XX; L: 44 cm, Gjer: 22 cm, Th: 21 cm; dru; ornamente rrethore të gdhendura në dy radhë. Paraqitur në "Dhomën e argjendarisë", kati i parë. I pa publikuar.

/12

/13

SHKAM (stol me 3 këmbë), fundi i shek. XX; L: 25 cm; dru; formë gjysmëhëne; tre këmbët e përforcuara me gozhdë hekuri. Nr. Inv. 2471. Paraqitur në "Dhomën e ritit mortor", kati përdhesë. I pa publikuar.

/14

SOFRA *e fëmijëve* ; fillimi i shek. XX; e përbërë nga një tryezë e ulët e rrumbullakët, stola të formave të ndryshme. Paraqitur në korridorin e katit përdhesë. I publikuar: Katalog nga Thesari Etnologjik i Muzeut të Kosovës, Prishtinë, 2013,18/Nr. 6

/15

TRYEZË ÇAJI DHE KAFEJE, fillimi i shek. XX; origjina: zona e Rrafshit të Kosovës; L: 46 cm, D: 35 cm, (sipërfaqja e epërme), L: 25 cm, D: 29 cm (sipërfaqja e poshtme); dy sipërfaqe gjashtëkëndore prej druri të gdhendura me motive floreale identike në formë të rombe, rozeta; kapëset janë bashkuar me dekorimin të gdhendur dhe harkuar. Paraqitur në korridorin e katit përdhesë. I publikuar: Katalog nga Thesari Etnologjik i Muzeut të Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 26/Nr. 20

/16

ULËSE E BRENDSHME, fillimi i shek. XX; L: 87 cm, Gjer: 130 cm. Thellësia e panelit të uljes: 39 cm; dru; ornamente gjeometrike dhe floreale të gdhendura në basoreliev përgjatë skajeve të ulëses, nga pas dhe në sipërfaqen e panelit të uljës. Inv. Nr. 749 Paraqitur në "Dhomën e artit folklorik", kati i parë. I pa publikuar.

/17

RRETHI I FËMIJËVE, fillimi i shek. XX; L: 46 cm, Gjat.: 45 cm, Gjer.: 32 cm; strukturë e thjeshtë druri, rrota druri. Nr. Inv. 105. Paraqitur në korridorin e katit përdhesë. I publikuar: Katalog nga Thesari i Muzeut të Kosovës, Prishtinë 2013,24/Nr. 17.

/18

DJEP, mesi i shek. XX; dru; ornamente gjeometrike (rreth, trekëndësh) shtypur në sipërfaqen e eksponatit; këmbët e djepit në formë gjysmë-rrethore lejojnë përkundjen. Nr. Inv. 241. Paraqitur në "Dhomën e lindjes", kati përdhesë. I pa publikuar.

// KATALOGU
KOLEKSIONI

VEGLA PUNEDORE

/19

Vek (Tezgjah), fillimi i shek. XX; dru. Paraqitur në "Dhomën e veshjeve tradicionale", kati i parë. I pa publikuar.

/20

ENDËS I TJERRIT (Çekërrk); mesi i shek. XX; origjina: rajoni Rozhajë; dru. Paraqitur në "Dhomën e veshjeve tradicionale", kati i parë. I pa publikuar.

/21

TJERRËSE, fillimi i shek. XX; dru; bazamenti prej guri. Nr. Inv. 2211. Paraqitur në "Dhomën e veshjeve tradicionale", kati i parë. I pa publikuar.

/22

KALLËPE DRURI për prodhim këpucës tradicionale (Opinga); shek. XX; Gjat: 36 cm, Gjer.: 10 cm; dru; linjë e shtypur dhe dekorim me pika në sipërfaqen e epërme. Nr. Inv. 101. Paraqitur në "Dhomën e artit folklorik", kati përdhesë. I pa publikuar.

/23

FURKË (vegël për tjerrje) – (Furka); fillimi i shek. XX; Gjat: 96 cm; dru; ornamente gjeometrike të shtypura në pjesën e sipërme të eksponatit. Nr. Inv.2069 Paraqitur në "Dhomën e veshjeve tradicionale", kati i parë. I pa publikuar.

/24

TJERRËSE, fillimi i shek. 20; Gjat: 45 cm; dru; dekoruar me motive gjeometrike mbi sipërfaqen e sheshtë të seksionit të mesëm Nr. Inv. 341. Paraqitur në "Dhomën e veshjeve tradicionale", kati i parë. I pa publikuar.

/25

TJERRËSE(shtizë), mesi i shek. XX; Gjat: 47 cm; dru; skajet janë të gdhendura për të lehtësuar mbledhjen e fijes. Nr. Inv. 342. Paraqitur në "Dhomën e veshjeve tradicionale", kati i parë. I pa publikuar.

/26

BOSHT TJERRËSE, fillimi i shek. XX; Gjat: 23 cm; dru. Nr. Inv. 2051. Paraqitur në "Dhomën e veshjeve tradicionale", kati i parë. I pa publikuar.



// KATALOGU
KOLEKSIONI

VEGLA BUJQËSORE DHE BLEGTORALE

/27

ZGJEDHË QESH, mesi i shek. XX; Gjat: 150 cm. Gjer: 42 cm; dru; dizajn i thjeshtë, dekorim gjysmërrethor mbi skajet e pjesës së epërme; dekorimi paraqet një gjarpër në seksionin qendror. Nr. Inv. 2561. Paraqitur në korridorin e katit përdhesë. I pa publikuar.

/28

VEGLA PËR QETHJE DELESH (gërshërë), fillimi i shek. të XX; Gjat: 30 cm; metalike; dorëzat janë të lidhura nga pas; tehet kanë formë trekëndore. Nr. Inv. 4465. Paraqitur në "Dhomën e artit folklorik", kati përdhesë. I pa publikuar.

/29

KËMBANË LOPE (Kambanë), shek. XX; metal; dru; kapëset e kambanave më të mëdha janë bërë nga druri me dekorim gjeometrik mbi sipërfaqen e jashtme. Më të voglat kanë kapëse të thjeshta metali. Paraqitur në korridorin e katit të parë. I pa publikuar.

/30

SHKOP PËR ECJE, fillimi i shek. XX; Gjat: 101 cm; dru; dekorim i thjeshtë me motive gjeometrike mbi sipërfaqen e dorezës; doreza është formuar si një gjarpër, si simbol i mbrojtjes. I përdorur nga njerzë të moshuar dhe barinjë. Nr. Inv. 1427. Paraqitur në "Dhomën e ritit mortor", kati i parë. I pa publikuar.

// KATALOGU
KOLEKSIONI

TEKSTILE FOLKLORIKE

/31

